



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-94
27.03.2025
Shkup

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10¹ të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 44 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Vendimin PA1 nr.08-362 datë 06.02.2025, („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.30/25 datë 12.02.2025) për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës dhe Lejen për transmetim në radio, PA1 nr.08-91 datë 19.03.2025, duke vendosur sipas Kërkesës, i ynë PA1 nr.08-91 datë 21.03.2025 për vazhdimin e afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë të SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë dhe Konkluzionin ark.nr.02-1280/3 datë 26.03.2025, në seancën e 14-të mbajtur më 26.03.2025, miratoi si vijon:

VENDIM
për vazhdimin e afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë të
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë

1. VAZHDOHET afati për fillimin e kryerjes së veprimtarisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë për transmetim në radio të shërbimit programor, radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm, në të cilin llojet e programeve të përfaqësuar përbushin së paku dy nga tre funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës.

2. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë, detyrohet të fillojë me kryerjen e veprimtarisë me datë 03.05.2025.

Në rast të mos respektimit të afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë cekur në paragrafin (1) të kësaj pike të Vendimit, në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligji të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Agjencia do të marrë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

3. Ky Vendim është përfundimtar dhe botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ dhe në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

¹Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në seancën e 4-të mbajtur më 05.02.2025 pas zbatimit të Konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, të shpallur në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpallje të konkursit publik, PA1 nr.08-275 datë 21.10.2024 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.219/24 datë 29.10.2024) kandidatit, parashtresit të fletëparaqitjes, personit fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, në pajtim me Fletëparaqitjen për dhënien e lejes përmes konkursit publik PA1 nr.08-362 datë 27.12.2024, i është dhënë leja për transmetim në radio të shërbimit programor, radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm në të cilën llojet e programeve të përfaqësuara përbushin së paku dy nga tre funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës.

Në pajtim me pikën 5 të Vendimit për dhënien e lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-362 datë 06.02.2025, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive themeluar nga kandidati i konkursit, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, të cilit i është dhënë leja, detyrohet të fillojë me kryerjen e veprimtarisë më 01.04.2025. Drejtuar Agjencisë më 14.03.2025, me autorizim të personit të emëruar, avokat nga Kumanova, është dorëzuar gjendja vijuese e SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë (themeluar nga kandidati Sasha Mitiq nga Kumanova) dhënë nga Regjistri Qendror i RMV-së më 13.03.2025, nga ku Agjencia më 19.03.2025, ndaj SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë ka dhënë leje për transmetim në radio, PA1 nr.08-91 datë 19.03.2025. Ku në lejen e dhënë për transmetim në radio PA1 nr.08-91 datë 19.03.2025, është përcaktuar se zotëruesi i lejes do të fillojë me kryerjen e veprimtarisë më 01.04.2025.

Me datë 21.03.2025, drejtuar Agjencisë nga autorizuesi i drejtuesit të SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë është dorëzuar Kërkesë i ynë PA1 nr.08-91, për vazhdimin e aftit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë të SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë, në të cilën është thënë se për shkak të tragjedisë në Koçan që ndodhi më 16.03.2025 dhe anulimit të paplanifikuar të aktiviteteve dhe detyrimeve për shkak të arsyeve objektive të paparashikuara të shkaktuara nga tragjedia, ka pasur vonesa të caktuara në lidhje me programin dhe përgatitjen teknike dhe fillimin e punës së radios, të cilët për momentin nuk mund të konfirmojnë me siguri se mund të përfundojnë deri më 01.04.2025. Konkretisht, personi fizik nga Koçani, i cili ishte angazhuar nga SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë për përgatitjen e pjesës teknike dhe instalimin e pajisjeve, si dhe për komunikimin dhe dorëzim të elaboratit dhe formularëve të nevojshëm në Agjencinë për Komunikime Elektronike (AKE), ka njoftuar se për shkak të tragjedisë në Koçan, e cila ka prekur dhe familjarë dhe të afërm të tij, nuk ka mundur që në kohë të caktuar të kryejë veprimet e lartpërmendura. Gjithashtu, është shpjeguar se para fillimit me punë të radios ishte planifikuar festë dhe ceremoni për fillimin e transmetimit të radios, si dhe promovim dhe marketing në rrjetet sociale, ekspozim fletushkash dhe/ose billborde në Kumanovë, me qëllim njohjen e qytetarëve për fillimin e punës së radios së re në qytetin e tyre, por duke pasur parasysh ditët e zisë të shpallur nga Qeveria e RMV-së dhe respektimin e tyre, këto veprime nuk u realizuan, nga ku shihet se nga sa më sipër kemi dhe një arsye për nevojën e shtyrjes së datës për fillimin e kryerjes së veprimtarisë. Duke marrë parasysh arsyet e mësipërme, në kërkesë thuhej se SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë kërkon vazhdimin e afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë, përkatësisht afati për fillimin e kryerjes së veprimtarisë të jetë më 03.05.2025. Njëkohësisht, si shtojcë e kërkesës në fjalë, dhe në drejtim të vërtetimit për seriozitet të transmetuesit për fillimin me kohë të kryerjes së veprimtarisë, është dorëzuar Marrëveshja e qirasë së paluajtshme (objekt transmtues) me SHTR Radio Kanal 77 SHPKNJP Shtip, për dhënie me qira të ambientit zyrtar RO Kumanovë në pronësi të SHTR Radio Kanal 77, me qëllim të instalimit të paisjeve telekomunikuese të radios dhe instalimeve të SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë, si dhe dy kërkesa për miratimin e përdorimit të radio frekuencave për shërbimin fiks dhe analog dorëzuar në AKE.

Në pajtim me nenin 2 paragrafi (1) të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio

(Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023, radiodifuzeri që të kryejë transmetim në radio në zonën për të cilën ka marrë lejen për transmetim në radio nga Agjencia, për nivel të caktuar dëgjimi (nivel lokal) duhet të posedon paisje dhe mjete teknike për të ofruar prodhim dhe transmetim cilësor të programit.

Duke marrë parasysh nga sa më sipër, Këshilli i Agjencisë, ka vendosur në lidhje me Kërkesën, i ynë PA1 nr.08-91 datë 21.03.2025 për vazhdimin e afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë të SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë, miratoi vendim për vazhdimin e afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë për transmetim në radio të shërbimit programor, radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara kryejnë së paku dy nga tre funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, të SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë, përcaktuar në pikën 5 të Vendimit PA1 nr.08-362 datë 06.02.2025 dhe Lejen për transmetim në radio, nr.08-91 datë 19.03.2025, kështu që afati për fillimin e kryerjes së veprimtarisë u përcaktua të jetë më 03.05.2025. Në rast të mosrespektimit të afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë, në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), Agjencia do ta marrë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 44 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Vendimin PA1 nr.08-362 datë 06.02.2025 („Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr.30/25 datë 12.02.2025) për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës dhe Lejen për transmetim në radio, PA1 nr.08-91 datë 19.03.2025, duke vendosur sipas Kërkesës, i ynë PA1 nr.08-91 datë 21.03.2025 për vazhdimin e afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë të SHTR RADIO SKVER SHPKNJP Kumanovë dhe Konkluzionin ark.nr.02- 1280/3 datë 26.03.2025, miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ dhe në ueb faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi, transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.